

VENDIM
Nr. 159, datë 19.2.2020

**PËR MIRATIMIN E BUXHETIT PËR AUTORITETIN E KOMUNIKIMEVE
ELEKTRONIKE DHE POSTARE, PËR VITIN 2020**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 117, të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008, "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e fondit të shpenzimeve të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), për vitin 2020, për shumën 384 760 000 (treqind e tetëdhjetë e katër milionë e shtatëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë, sipas pasqyrës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Pasqyra nr. 1

**PLANI I SHPENZIMEVE TË AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE
ELEKTRONIKE DHE POSTARE PËR VITIN 2020**

Të ardhura	Në mijë lekë	Shpenzime	Në mijë lekë
Të ardhura nga pagesa për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike	164,000	Shpenzime për paga	117,711
Të ardhura nga pagesa për caktimin e përdorimit e frekuencave	132,000	Shpenzime për sigurimet shoqërore e shëndetësore	14,989
Të ardhura nga pagesa për numeracionin	26,000	Shpenzime për materiale	8,546
Të ardhura nga pagesa për koston e shërbimit të portabilitetit të numrit	20,160	Shpenzime për shërbime	154,354
Të ardhura nga pagesa për mbikëqyrjen e tregut të shërbimit postar	8,500	Shpenzime për investime	89,160
Të ardhura nga pagesa për domain	9,400		
Të ardhura nga pagesa të tjera	700		
Të ardhura nga agjenti tatimor	24,000		
Totali i të ardhurave	384,760	Totali i shpenzimeve	384,760